



This programme is funded  
by the European Union



Gender Alliance for Development Center  
**Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim**



# *Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore*

## *Bashkia Vlorë*

### *2017*

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (RrFGSh), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga QAGJZH dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të **Komisionit Evropian**. Programi synon krijimin e një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të mundësuar ulje të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

#### **Autorët**

Ines Leskaj  
Megi Llubani  
Xhensila Murati  
Gentiana Xhelili

## Tabela e përmbajtjes

<b>TABELA E PËRMBAJTJES</b> .....	<b>3</b>
<b>SHKURTIME</b> .....	<b>5</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>6</b>
<b>METODOLOGJIA</b> .....	<b>8</b>
<b>TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR BASHKINË E VLORËS</b> .....	<b>10</b>
<b>MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020</b> .....	<b>13</b>
GJETJET KRYESORE .....	13
<b>TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME DHUNËN NË FAMILJE</b> .....	<b>15</b>
<b>REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2017</b> .....	<b>18</b>
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE .....	18
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE .....	19
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA .....	26
<b>REKOMANDIME NË BAZË TË MONITORIMIT TË PUNËS KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE NË BASHKINË VLORË</b> .....	<b>27</b>
<b>ANEKSE</b> .....	<b>29</b>
ANEKSI 1- DETYRAT E KOORDINATORIT PËR BARAZI GJINORE DHE KUNDËR DHUNËN NË FAMILJE .....	29
ANEKSI 2- DETYRAT E TË GJITHË ANËTARËVE QË KANË NËSHKRUAR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT SI PJESTARË TË MEKANIZMIT TË RREFERIMIT KUNDËRDHUËS ME BAZË GJINORE .....	29

## Lista e tabelave

Tabela 1. Profili i Bashkisë Vlorë.....	11
Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e Vlorës .....	11
Tabela 3. Të dhëna mbi përfituesit e pagesave sociale në Bashkinë Vlorë.....	12
Tabela 4. Numri i kërkesë padive për UMM.....	15
Tabela 5. Gjinia e viktimës.....	16
Tabela 6. Statusi civil i viktimës .....	16
Tabela 7. Arsimimi i viktimës .....	16
Tabela 8. Zona e banimit të viktimës .....	16
Tabela 9: Lidhja e viktimës me autorin.....	17
Tabela 10. Numri i zgjidhjeve të martesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .....	17
Tabela 12. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve .....	20
Tabela 13. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve.....	20

Tabela 14. Koordinator vendor kundër DhBGj .....	20
Tabela 15. GTN-ja e Bashkisë Vlorë ( Kjo sipas MOU 2011).....	22
Tabela 16. MRR-ja e Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2017 .....	22
Tabela 17. GTN e Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2017 .....	23
Tabela 18. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Vlorë .....	27

## Shkurtime

<b>ASPA</b>	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BGj</b>	Barazia Gjinore
<b>DhBGj</b>	Dhunë me bazë Gjinore
<b>DhF</b>	Dhunë në Familje
<b>DhKG</b>	Dhunë ndaj Grave
<b>GTN</b>	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave në Shqipëri
<b>IZhA</b>	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
<b>KONVENTA CEDAW</b>	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>KONVENTA E STAMBOLLIT</b>	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
<b>KD</b>	Komiteti Drejtues
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MKR</b>	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
<b>MRR</b>	Mekanizmi i Referimit të Rasteve
<b>(MMSR)MShMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>NBGj</b>	Nëpunës i Barazisë Gjinore
<b>NjVQV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>OJF</b>	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
<b>OShC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>OSCE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PKV</b>	Plani Kombëtar i Veprimit
<b>PShSh</b>	Policia e Shtetit Shqiptar
<b>QAGjZh</b>	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
<b>QZhK “Sot për të Ardhmen”</b>	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
<b>REVALB</b>	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
<b>RrFGSh</b>	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
<b>SKBGj</b>	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
<b>ShGPS</b>	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
<b>UM</b>	Urdhër Mbrojtjeje
<b>UMM</b>	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
<b>UN WOMEN</b>	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## Hyrje

**Projekti** “Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020” në lidhje me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje gjatë periudhës Nëntor 2017 – Tetor 2019. Në Shqipëri projekti zbatohet nga QAGjZh dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kunder dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Njësitë administrative të përfshira në monitorim janë bashkitë e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit. Njëkohësisht, po në kuadër të zbatimit të Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, monitorimi ndërmerret edhe për aktivitetet e planifikuara në nivel kombëtar.

Qëllimi i projektit është krijimi i një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Procesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2010-2020 është duke u zhvilluar përgjatë periudhës Mars 2018 - Shtator 2019. Aktivitetet në nivel qendror do të monitorohen nga QAGjZh dhe RrFGSh përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e aktiviteteve të PVK 2016-2020 nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërsa aktivitetet në nivel vendor do të monitorohen nga organizatat lokale, disa prej tyre anëtare të RrFGSh.

Arritjet e pritshme: 1) OShC-të kanë kapacitetet e nevojshme për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020; 2) Procesi i monitorimit nga OShC-të përfundohet me sukses për vitin 2018 dhe 2019; 3) Realizimi i procesit të advokimit nga OShC-të, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e ka nisur punën me organizimin e seancave informuese me OShC-të në 6 bashkitë e synuara, duke vijuar më pas me zhvillimin e një manuali/udhëzuesi për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, për përdorim gjatë trajnimeve me OShC-të lokale që do të monitorojnë Qëllimin Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Përvec manualit u hartuan disa skeda monitoruese të cilat u ndërtuan bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Procesi i monitorimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020 është duke u realizuar në të gjashtë bashkitë, si dhe në nivel qendror, për 2 vite me radhë (2018 dhe 2019). Pjesë e procesit monitorues janë edhe aktivitetet e planit të veprimit të zbatuara gjatë vitit 2017. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit do të analizohen dhe në bazë të kësaj analize do të hartohen raportet (2018, 2019) me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Pas publikimit të raporteve, do të organizohen tryeza të rrumbullakëta në çdo qark lidhur me gjetjet e procesit monitorues, pasuar nga takime advokuese me instancat vendimmarrëse e politikëbërëse. Paralelisht, do të bashkëpunohet me profesionistë të medias për të raportuar periodikisht gjetjet dhe rekomandimet e dala përfshirë informimin në mediat sociale, por edhe për të ngritur kapacitetet e tyre rreth raportimit të ndjeshëm gjinor.

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet e raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

### ***Rreth organizatave zbatuese***

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh është një organizatë jo-fitimprurëse, e krijuar në vitin 2009, që punon në fushën e të drejtave të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është fuqizimi social, ekonomik, kulturor dhe politik i gruas shqiptare. Rrjeti përbëhet nga 10 organizata të cilat shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu në jug:

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Forumi i Gruas Elbasan
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale
- Shoqata Unë Gruaja, Pogradec
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi
- Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër
- Shoqata Jona, Sarandë
- Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, Tiranë

Për bashkinë e Vlorës monitorimi i mbledhjeve të mekanizmit të referimit dhe raporti u hartua me ndihmën e eksperteve Gentiana Xhelili dhe Xhensila Murati, të Qendrës për Promovim e Zhvillim Social.

Qendra për Provim dhe Zhvillim Social (QZhPS) është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar në vitin 2016, e cila operon në qarkun e Vlorës. QZhPS ka për mision të mbështesë, të mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e fëmijëve, të rinjve, grave dhe grupeve të marginalizuara. Aktivitetet kryesore të qendrës janë: vlerësim psikologjik, këshillim psikologjik, terapi zhvillimi për fëmijët me nevoja të veçanta, mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta për një edukim gjithëpërfshirës, mbështetje psikologjike dhe sociale për familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta, promovim i të drejtave të personave me nevoja të veçanta dhe grupeve të marginalizuara.

QZhPS ka qenë pjesë e takimeve të organizuara në lidhje me inisiativat e ndërmarra nga: Bashkia Vlorë; Shërbimi Social Vlorë; Njësia Kundra Dhunës në Familje Vlorë; Njësia Për Mbrojtjen e

Fëmijëve Vlorë; institucione shtetërore dhe organizata jofitimprurëse. Në kuadër të bashkëpunimit është përfshirë në Planin e Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe në zbatim të këtij plani. Prej muajit maj 2016 është pjesë aktive e skuadrave të terrenit për identifikimin e fëmijëve viktime të keqtrajtimit, abuzimit dhe shfrytëzimit.

### ***Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?***

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktime të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatohet një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

## **Metodologjia**

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Dy monitoruese u përzgjodhën për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2017 dhe fillim vitin 2018.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:



1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
  - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
  - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
  - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
  - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuere të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikatat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rasteve të dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online

regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën [WWW.revalb.org](http://WWW.revalb.org)

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

## Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë e Vlorës

**Figura 1. Harta Administrative e Bashkisë Vlorë**



**Burimi: STAR 2, UNDP**

Bashkia e Vlorës është një bashki më vete që në fillesat e ndarjeve administrative në Shqipëri, por pas Refromës Administrative – Territoriale të vitit 2015 u zgjerua edhe më tej. Bashkia përbëhet nga pesë njësi administrative: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e qarkut të Vlorës.

**Tabela 1. Profili i Bashkisë Vlorë**

Bashkia	Qendra e bashkisë	Njësitë administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje
Vlorë	Qyteti Vlorë	Vlorë	Qyteti Vlorë
		Orikum	Qyteti Oriku, Fshatrat: Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë
		Qendër Vlorë	Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan
		Novoselë	Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërn
		Shushicë	Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çepirat, Risili

**Burimi: Bashkia Vlorë**

Bashkia e Vlorës numëron rreth 195,848 banorë, për pesë njësitë e veta administrative, ku përfshihen 2 qytete dhe 37 fshatra, të regjistruar sipas regjistrit të gjendjes civile të vitit 2016, ndërkohë sipas Cencusit të vitit 2011 kjo bashki numëronte si popullsi rezidente 104,827 banorë. Vihet re se është pikërisht qyteti i Vlorës në të cilin është e përqendruar 70% e popullsisë së bashkisë. Numri total i familjeve për Bashkinë Vlorë është 57,400. Njësia administrative me popullsinë dhe numrin e familjeve më të vogël në këtë bashki është njësia e Shushicës.

**Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e Vlorës**

Njësitë administrative	Numri i fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrit Civil 2016			Popullsia sipas Cencusit 2011		
			Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Vlorë	-	42,427	69,706	68,832	138,538	39,617	39,896	79,513
Orikum	4	3,258	6,064	5,798	11,862	2,717	2,786	5,503
Qendër Vlorë	12	4,766	9,721	9,034	18,755	3,816	3,805	7,621
Novoselë	12	4,352	8,786	8,273	17,059	4,086	4,123	8,209
Shushicë	9	2,597	5,006	4,628	9,634	2,026	1,955	3,981
<b>Total</b>	<b>37</b>	<b>57,400</b>	<b>99,283</b>	<b>96,565</b>	<b>195,848</b>	<b>52,262</b>	<b>52,565</b>	<b>104,827</b>

**Burimi: Bashkia Vlorë**

Përveç qytetit të Vlorës, në të cilin funksionojnë 3 çerdhe ku janë të angazhuar 3 edukatore për 71 fëmijë të regjistruar, në asnjë prej njësive administrative të tjera të kësaj bashkie nuk ka çerdhe. Në Bashkinë Vlorë operojnë si institucione arsimore parashkollore 49 kopshte, ku 19 prej tyre janë në qytetin e Vlorës. Në total janë të regjistruar në këto kopshte 3,297 fëmijë dhe janë të angazhuar profesionalisht 210 edukatore.

Bashkia Vlorë ka 45 shkolla nëntëvjeçare dhe 12 shkolla të mesme. Në njësinë administrative të Novoselës nuk ka asnjë shkollë të mesme. Në 45 shkollat nëntëvjeçare janë në total të regjistruar 10,382 nxënës dhe të angazhuar profesionalisht 782 mësues, ndërsa në shkollat e mesme figurojnë të regjistruar 4,314 nxënës dhe japin mësim 289 mësues.

Në gjithë territorin e bashkisë së Vlorë ka dy spitale që ofrojnë shërbim të specializuar mjekësor, të cilët ndodhen në qytetin e Vlorës. Për të përmbushur nevojat e komunitetit operojnë 9 qendra shëndetësore, të pozicionuar 5 qendra në Qytetin e Vlorës, dhe nga një për secilën prej njësive administrative të tjera. Ndërkaq, krahas tyre numërohen përgjatë territorit të bashkisë dhe 38 ambulanca, numri më i madh i të cilave është i përqendruar në zonat rurale me popullsi më të madhe, në njësitë administrative Novoselë dhe Qendër. Përsa i përket kapaciteteve njerëzore, figurojnë të angazhuar në këto struktura të shëndetit 73 mjekë dhe 211 infermierë.

Numri total i individëve në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike në këtë bashki është 2,154 persona. Bashkia Vlorë ka gjithsej 756 familje përfituese të ndihmës ekonomike me mbështetje monetare si pasojë e mos-plotësimit të nevojave jetike. Sipas të dhënave të poshtë listuara në tabelë numri i subjekteve përfituese të pagesës për personat me aftësi të kufizuar rezulton të jetë në total 2,280 persona. Në këtë kuadër, janë gjithashtu 703 individë që trajtohen në cilësinë e kujdestarit me pagesë, të cilët janë persona të caktuar për t'u kujdesur për personin me aftësi të kufizuara dhe ofrojnë shërbim për të në veprimtarinë e përditshme.

**Tabela 3. Të dhëna mbi përfituesit e pagesave sociale në Bashkinë Vlorë**

Njësia administrative	Përfituesit e ndihmës ekonomike (NE)		Numri i popullsisë përfituese (frymë) të pagesës së paaftësisw	
	Numri për frymë	Numri i familjeve	Numri i personave me aftësi të kufizuar	Numri i kujdestarëve
Vlorë	1,812.00	682.00	1,664.00	545.00
Orikum	34.00	14.00	127.00	29.00
Qendër Vlorë	25.00	5.00	189.00	48.00
Novoselë	-	-	183.00	49.00
Shushicë	283.00	55.00	117.00	32.00
<b>Total</b>	<b>2,154.00</b>	<b>756.00</b>	<b>2,280.00</b>	<b>703.00</b>

*Burimi: Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social, Bashkia Vlorë*

## Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

*Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet raportimeve per vitet 2018 dhe 2019.*

### Gjetjet kryesore

- Mekanizmi vendor për rastet e dhunës në familje<sup>1</sup> nuk ka funksionuar siç duhet përgjatë vitit 2017. Janë zhvilluar vetëm dy mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisciplinar (GTN) dhe asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues (KD), ndërkohë që numri i raportimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Vlorë ka qenë 277 raste për vitin 2017. Vetëm disa institucione janë aktive, kryesisht përfaqësuesit e bashkisë dhe policia. Koordinator i vendor i kësaj bashkie është i përkushtuar dhe organizon takime të herëpashërshme sipas rasteve dhe emergjencës, pavarësisht se vetë GTN-ja është mbledhur vetëm 2 herë shumë raste janë trajtuar ad – hoc.
- Jo të gjithë aktorët që janë pjesë e mekanizmit të referimit marrin pjesë në mbledhjet e Grupit Teknik Ndërdisciplinar. Gjithashtu përtej mbledhjeve të GTN sa herë paraqiten raste të referuara, nuk ka takime të rregullta të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR).
- Qendrueshmëria e stafit përgjegjës për adresimin e dhunës me bazë gjinore në bashkinë e Vlorës është një aspekt pozitiv pasi krijon memorie institucionale dhe rrit efikasitetin e investimit për trajnimin dhe formimin profesional të personit përgjegjës. Megjithatë, mbingarkesa e koordinatorit me role dhe përgjegjësi të ndryshme ndikon në rregullsinë e hedhjes së të dhënave të referuara apo mirëfunksionimin e mekanizmave përkatës për adresimin e dhunës me bazë gjinore në bashki.
- Prania e disa organizatave joqeveritare, të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore lehtëson dhe plotëson punën e bashkisë në adresimin e fenomenit në territorin e bashkisë.

---

<sup>1</sup> “Mekanizmat vendorë për rastet e dhunës në familje”. Sipas VKM Nr. 334, datë 17. 2. 2011 “Për mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij”, mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: a) Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; b) Ekipet teknike ndërdisciplinore; c) Koordinatorët vendorë për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, funksionojnë pranë çdo bashkie. Komitetet drejtuese kryesohen nga Kryetari i Bashkisë dhe në përbërje kanë: a) Përfaqësuesin e strukturës së policisë; b) Përfaqësuesin e gjykatës së rrethit gjyqësor; c) Përfaqësuesin e prokurorisë së rrethit; ç) Përfaqësuesin e drejtorisë arsimore; d) Përfaqësuesin e Drejtorisë së Shëndetit Publik; dh) Drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë; e) Përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale në komunë; ë) Përfaqësuesin e zyrës së përmbartimit; f) Përfaqësuesin e prefekturës; g) Kryetarët e komunave që janë në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki; gj) Përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimin; h) Drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të dhunës në familje; i) Drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore, ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë; j) Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare; k) Drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit.

- Mungojnë banesa sociale për strehim dhe akomodim afatagjatë të rasteve të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- Në buxhetin e bashkisë nuk ka një zë të veçantë për mirëfunksionimin e mekanizmit të referimit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve të mekanizmit.
- Mungon infrastruktura transportuese në dispozicion të bashkisë për transportin fizik të viktimave të dhunës drejt qendrave të specializuara të shërbimit.
- Nevojitet lehtësim i procedurave për përfitimin e bonuseve sociale nga bashkia e Vlorës për viktimat e dhunës në familje
- Në bashkinë Vlorë mungon një qendër emergjence për akomodimin e rasteve që paraqesin nevoja urgjente si edhe mungon një linjë këshillimi dhe qendër rehabilitimi për dhunuesit pasi bashkia vetë nuk ofron shërbime këshillimi.
- Në bashkinë e Vlorës nuk ka shërbime të specializuara për trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje për rastet kur viktimat përballen me probleme të shëndetit mendor.
- Sistemi kombëtar online për hedhjen e të dhënave, krijon shpesh probleme teknike, të cilat vështirësojnë përditësimin në kohë reale me rastet e ndryshme.
- Referimi i rasteve kundër dhunës në familje pranë anëtarëve të tjerë të mekanizmit, nuk bëhet rregullisht nga policia, por të dhënat merren nga gjykata në lidhje me UM dhe UMM, pra pasi viktimat kalojnë procedurën në gjykatë. Është e rëndësishme që policia të lajmërojë koordinatorin menjëherë, në mënyrë që rastet të referohen në mënyrë të rregullt dhe të ketë reagim sa më të shpejtë në rastet emergjente.
- Megjithëse numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje është i lartë 277 raste, përgjatë gjithë vitit ka pasur vetëm 10 raste të ndjekura në mënyrë ndërdisiplinare nga ana e mekanizmit të referimit, që tregon se mund të ketë bashkëpunim, koordinim dhe ndarje më të mirë dhe efikase të të dhënave, në mënyrë që të gjitha rastet e raportuara të ndiqen nga mekanizmi.
- Bashkia Vlorë nuk ka alokuar mjaftueshëm fonde për aktivitete ndërgjegjësuese si pankarta, fletëpalosje ku të flitet për dhunën dhe të jepen numrat kombëtarë të institucioneve që adresojnë dhunën në familje në Shqipëri. Bashkia Vlorë ka alokuar dy shuma në lidhje me dhunën në familje gjatë vitit 2017. Pagën e koordinatores 650,880 lekë (54,240 leke/muaj x 12 muaj) dhe financimin e disa aktiviteteve të Qendrës Vatra për viktimat e dhunës në familje rreth 540,000 leke/vit.
- Evidentohet gjithashtu se njësitë e mbrojtjes së fëmijës mblidhen më shpesh, por duke qënë se ato nuk janë objekt i këtij raporti nuk dihet nurmi i saktë i takimeve të tyre. Por ajo që vlen për tu theksuar është që pasi realizohen takimet në lidhje me fëmijët e përfshirë në rastet e dhunës në familje, askush nuk kujtohet të trajtojë çështjen e grave (nënave të këtyre fëmijëve dhe gjithçka quhet e ezaurur në lidhje me rastin nëse diskutohet dhe i jepet mbrojtje fëmijës).
- Nuk ka asnjë organizatë në Vlorë që ofron shërbime rehabilituese të specializuara për dhunuesit. Megjithatë Qendra Vatra në momentin e parë të rënies në kontakt me dhunuesin në ambientet e policisë ofron këshillime psiko-sociale për dhunuesin nëpërmjet psikologut dhe punonjësit social. Duhet theksuar se Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë nuk ka të atashuar pranë këtij institucioni një psikolog. Në këto kushte për të gjitha rastet e dhunës në familje ofron asistencën e saj psikologjia e Qendrës Vatra.
- Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur referime për raste të viktimave drejt Zyrës së Punësimit. Ndërkohë, kjo zyrë është e hapur të parashtrijë të gjitha ofertat e tregut të punës në

përputhje me nevojat, kapacitetet dhe kërkesat e rasteve të referuara për ndërmjetësim për punësim.

### **Të dhëna statistikore në lidhje me dhunën në familje**

Në vitin 2017, 7.7% e grave që përjetuan dhunë në familje në Shqipëri vinin nga qarku i Vlorës<sup>2</sup>, duke e renditur kështu të pestin ndër 12 qarqet e Shqipërisë për sa i përket dhunës së raportuar ndaj grave. Nga ana tjetër, Vlorë renditet e dyta për nga norma e raportimit të dhunës nga ana e grave, ku 26.6 gra në 10,000 banorë e raportojnë dhunën në polici<sup>3</sup>. Mesatarja kombëtare në vitin 2017 ishte rreth 22 denoncime për 10,000 banorë.<sup>4</sup> Në bazë të statistikave të Gjykatës së Rrethit Vlorë për vitin 2017 çështja e dhunës në familje me 191 çështje në shqyrtim, renditet e dyta pas çështjeve në shqyrtim për veprën penale të vjedhjes. Në total janë regjistruar për këtë vit 1081 çështje, që do të thotë se dhuna në familje zë 18% të rasteve të trajtuara në gjykatë.<sup>5</sup>

Sipas të dhënave të mbledhura nga RrFGSh për vitin 2017, nga 145 vendime gjyqësore, 88.28% e rasteve kishte gra në palën paditëse, norma më e lartë krahasuar me qytetet e tjera të monitoruara.<sup>6</sup> Janë plotësuar 222 kërkesë Padi për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje nga Komisarati i Policisë i Bashkisë Vlorë.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Vendore e Policisë e Qarkut Vlorë<sup>7</sup>, gjatë vitit 2017 janë evidentuar gjithsej 277 raste të dhunës në familje me 87 autorë, nga të cilët 32 autorë të arrestuar në flagrancë, 54 autorë ndiqen në gjendje të lirë dhe 1 autor i shpallur në kërkim. Nga këto 222 raste kanë qenë në Komisaratin e Policisë Vlorë, 52 raste në Komisaratin e Policisë Sarandë, 3 raste në Komisaratin e Policisë Delvinë. Gjatë vitit 2017-s janë bërë 183 kërkesë padi për urdhëra mbrojtje apo të menjëhershëm mbrojtje. Ndërkohe në gjykatë janë regjistruar 183 kërkesa për urdhëra prej te cilave 18 UM dhe 165 UMM.

**Tabela 4. Numri i kërkesë padive për UMM**

Drejtoria Vendore Policisë së Qarkut Vlorë	Kërkesë padi për UMM
Komisariati policisë Vlorë (Bashkia Vlorë)	222
Komisariati i policisë Sarandë	52
Komisariati i policisë Delvinë	3
Total	277

**Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë**

<sup>2</sup> Qarku i Vlorës përfshin 7 bashki. Bashkitë e Vlorës, Selenicës, Himarës, Sarandës, Delvinës, Konispolit dhe Finiqit.

<sup>3</sup> Instituti i Statistikave. 2018. Burra dhe Gra në Shqipëri 2017. Online: <http://ëëë.instat.gov.al/rreth-nesh/aktivitetet/promovimi-i-aktiviteteve-statistikore/burra-dhe-gra-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2018/>

<sup>4</sup> Instituti i Statistikave. 2018. Burra dhe Gra në Shqipëri 2017. Online: <http://ëëë.instat.gov.al/rreth-nesh/aktivitetet/promovimi-i-aktiviteteve-statistikore/burra-dhe-gra-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2018/>

<sup>5</sup> Gjykata e Rrethit Vlorë. 2018. Çështjet Penale. Online: <http://ëëë.gjykata.gov.al/rrethi-vlor%C3%AB/gjykata-e-rrethit-vlor%C3%AB/statistika/c%C3%ABshjtjet-penale/>

<sup>6</sup> AËEN. 2018. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt leshimin e UMM/UM në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Korce, Diber dhe Sarandë.

<sup>7</sup> Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë mbulon 7 bashkitë e qarkut

Duke bërë një analizë të shkurtër të 277 rasteve të evidentuara gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017 vërehet se kanë qenë 270 gra e vajza dhe vetëm 7 burra që kanë pësuar dhunë në qarkun e Vlorës nga të cilët 222 raste në Bashkinë e Vlorës. Më tej të dhënat e marra nga policia tregojnë se moshja e viktimës së dhunuar në 215 raste ka qenë nën 18 vjeç kundrejt 62 raste mbi 18 vjeç.

**Tabela 5. Gjinia e viktimës**

<b>Femër</b>	<b>270</b>
<b>Mashkull</b>	<b>7</b>
<b>Total</b>	<b>277</b>

*Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë*

Në tabelën më poshtë vërehet se shumica e viktimave janë të martuara 238 prej tyre kundrejt 32 të divorcuara dhe 7 beqarë.

**Tabela 6. Statusi civil i viktimës**

<b>Të martuar</b>	<b>238</b>
<b>Divorcuar</b>	<b>32</b>
<b>Beqar</b>	<b>7</b>
<b>Total</b>	<b>277</b>

*Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë*

Sic shihet më poshtë në tabelën për arsimimin e viktimës, ky aspekt nuk ndikon shumë në dhunimin e tyre. Madje viktimat me arsim 9-vjeçar dhe ato me arsim te mesëm janë pothuaj të barabarta në numër.

**Tabela 7. Arsimitimi i viktimës**

<b>Analfabet</b>	<b>1</b>
<b>Arsim fillor</b>	<b>18</b>
<b>Arsim 9 vjeçar</b>	<b>100</b>
<b>Arsim i mesëm</b>	<b>139</b>
<b>Arsim i lartë</b>	<b>19</b>
<b>Total</b>	<b>277</b>

*Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë*

Shumica e viktimave vijnë nga zonë urbane dhe kjo për dy arsye ose në zonën rurale nuk kanë informacionin e duhur dhe druhen më shumë për të raportuar ose dhuna në zonat urbane është më e egër.

**Tabela 8. Zona e banimit të viktimës**

<b>Zonë urbane</b>	<b>201</b>
<b>Zonë rurale</b>	<b>76</b>
<b>Total</b>	<b>277</b>

*Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë*



Ajo që bie në sy në tabelën më poshtë është numri i madh i autorëve në lidhje të tretë me viktimën si kunati/kunata/vjehrra/nuse.

**Tabela 9: Lidhja e viktimës me autorin**

<b>Bashkëshorti</b>	<b>112</b>
<b>Bashkëshortja</b>	3
<b>Ish bashkëshorti</b>	32
<b>Fëmija</b>	10
<b>Prindi</b>	34
<b>Vëllai</b>	9
<b>Lidhje të treta: kunati/kunata/vjehrra/nuse</b>	77
<b>Total</b>	<b>277</b>

*Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë*

**Tabela 10. Numri i zgjidhjeve të martesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Vitet	Numri i martesave të zgjidhura
<b>2014</b>	47
<b>2015</b>	66
<b>2016</b>	23
<b>2017</b>	39

Megjithëse numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje për vitin 2017 është i lartë (277 raste viktime të dhunës sipas Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Vlorë), vetëm 10 raste janë trajtuar në mënyrë ndërdisiplinare nga mekanizmi i referimit, një përqindje tepër e ulët kjo krahasuar me rastet e raportuara, që tregon se mund të bëhet më tepër punë për referimin fillestar të rasteve dhe ndjekjen e tyre në vazhdim.

Në bashkinë Vlorë, përveç rasteve të dhunës në familje, gjatë muajit Tetor të vitit **2017**, është paraqitur rasti i një vajze, viktimë e dhunës në familje dhe dhunës seksuale. Rasti në fjalë është abuzuar seksualisht nga i ati. Pasi ka kërkuar ndihmë pranë Policisë, koordinatori vendor i dhunës në familje dhe specialistë nga shërbimi social rajonal kanë bërë vlerësimin e nevojave të rastit pranë familjes. Në vijim rasti iu nënshtrua kontrollit mjeko-ligjor, nga i cili rezultoi se viktimja ishte abuzuar seksualisht dhe kishte abortuar. Edhe pse rasti nuk u ndoq nga GTN, iu dha zgjidhje me koordinimin e Shërbimit Social Rajonal dhe koordinatorit vendor kundër dhunës në familje. Abuzuesi u ndoq penalisht dhe vuajti dënimin me burg ndërkohë viktimja u kthye në familje dhe u mbështet në vazhdimësi me këshillime psikologjike nga psikologu i Qendrës “Vatra”

## Rezultatet e Monitorimit – Viti 2017

### *Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.*

Sikurse në bashkitë e tjera angazhimi kryesor i bashkisë Vlorë në lidhje me objektivin 3.1 të SKBGJ për rritjen e ndërgjegjësimin për të mos pranuar dhe toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore, është zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit. Në kuadër të fushatave ndërgjegjësuere kombëtare, janë realizuar 3 aktivitete të koordinuara nga kjo bashki. Gjatë muajit nëntor 2017, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës në Familje, janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuere në gjashtë shkolla publike dhe jopublike, 9- vjeçare dhe të mesme të qytetit të Vlorës: Shkolla e Mesme “Xhyheri”, Shkolla “Marigo Posio”, Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Jani Minga”, Shkolla “Naim Frashëri”, “Selam Musai”, “Hajro Çakërrri”. Institucionet vendore dhe organizatat e përfshira në këto aktivitete kanë qenë Bashkia Vlorë (koordinatori vendor i dhunës në familje dhe punonjësja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve), Qendra “Vatra”, Qendra “Aulona”, Qendra Shtetërore Rinore dhe Policia. Gjithsej në këto aktivitete janë përfshirë 7 specialistë.

Për aktivitetet sensibilizuese në shkolla nuk janë shpenzuar fonde. Më së shumti aktivitetet kanë konsistuar në informimin me gojë të nxënësve për fenomenin e dhunës. Përtej aktiviteteve ndërgjegjësuere në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit nuk ka fushata thelbësore dhe të vazhdueshme nga ana e bashkisë, në bashkëpunim edhe me organizatat lokale për të adresuar dhunën me bazë gjinore. Për rrjedhojë është i nevojshëm, dedikimi i më shumë burimeve financiare dhe njerëzore për t'u koordinuar me aktorë të ndryshëm dhe për të siguruar mbulim sa më të gjerë të popullsisë në aktivitete ndërgjegjësuere. Buxheti për aktivitete të dhunës në familje është i nevojshëm jo vetëm si objektivi i SKBGj 2016 - 2020, por edhe si një prej aspekteve më të rëndësishëm për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri dhe për të ndikuar në ndryshimin e mendësisë për të mos pranuar dhe toleruar dhunën me bazë gjinore si pjesë normale e marrëdhënieve ndërmjet burrave dhe grave.

OShC-të që punojnë në lidhje me dhunën me bazë gjinore:

- 1- Qendra Psikosociale Vatra
- 2- Qendra Rinore e Vlorës
- 3- World Vision
- 4- Qendra Aulona
- 5- Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social

Aktivitete në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit:

- 1- Në kuadër të ditës ndërkombëtare kundër dhunës ndaj fëmijës, Shërbimi Social, Bashkia Vlorë dhe World Vision organizuan një forum ndërgjegjësuere, informues dhe sensibilizues mbi fenomenin e dhunës ndaj fëmijëve, neglizhimit, abuzimit dhe shfrytëzimit me nxënës të shkollave 9-vjeçare ku ishin të pranishëm edhe kryetari i bashkisë dhe një deputete. Aktiviteti u moderua nga drejtoresha e shërbimit social shtetëror rajonal dhe përfshinte shpërndarjen e fletëpalosjeve me mesazhe ndërgjegjësuere.
- 2- Në datë 22 nëntor, bashkia e Vlorës zhvilloi një tjetër aktivitet ndërgjegjësuere me nxënës të shkollave 9-vjeçare në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore

organizuar nga Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social në bashkëpunim me policinë vendore, qendrën Vatra, World Vision dhe anëtarë të komunitetit. Aktiviteti moderohet nga koordinatori i dhunës pranë bashkisë. Aktiviteti fokusohet në raportin ndërmjet prindërve dhe fëmijëve dhe rolin e tyre në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

- 3- Në datë 23 nëntor, bashkia e Vlorës zhvilloi një aktivitet me fokus sërish tek dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje në një shkollë 9-vjeçare ku ndër të tjera u diskutua edhe ligji për masat e dhunës në familje.

Qendra "Vatra", me rastin e ditës ndërkombëtare të gruas, në bashkëpunim me organizata e institucione lokale, organizoi aktivitet publik nën sloganin "Unë jam supergrua!". Ky aktivitet ishte vijim i aktivitetit të nisur në Tiranë nga RrFGSh, rrjet në të cilin Vatra bën pjesë. Aktiviteti konsistoi në shpërndarjen e materialeve informuese, dhurimin e luleve për gra e vajza dhe vendosjen e një banderole ku u afishua sloganin i lartpërmendur dhe gra e vajza nga komuniteti vendosën shenjën e dorës së tyre për të treguar në mënyrë simbolike se edhe ato i bashkohen kauzës.

Gjithashtu, Qendra "Vatra" në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore (25 Nëntor - 10 Dhjetor 2017), në bashkëpunim me RrFGSh, dhe Drejtorinë e Policisë Vendore Vlorë, Njësinë e Dhunës në Familje Bashkia Vlorë dhe Qendra Rajonale Rinore realizoi 4 seanca informuese me pjesëmarrjen e 125 nxënësve të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit të Vlorës. Gjithashtu, avokati dhe psikologu i qendrës zhvilluan në datë 24 Nëntor bisedë në televizionin "Real Tv" nën sloganin "T'i japim fund dhunës ndaj grave dhe vajzave pa lënë asnjë mënjanë" ku u diskutua mbi problematikën e dhunës në familje, masat ligjore dhe profilin e viktimave të dhunës dhe dhunuesve.

### *Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.*

Në bashkinë e Vlorës, GTN –ja mblidhet vetëm atëherë kur koordinatori vendor njihet me një rast që paraqet nevojë emergjente për ndërhyrje. Ndërsa për rastet që kërkojnë ndërhyrje jo multidisiplinare, pasi bëhet vlerësimi i nevojave të rastit, koordinatori e referon rastin te ofruesi i shërbimit. Mbetet ende sfidë mbledhja e komitetit drejtues kundër dhunës me bazë gjinore, pasi gjatë vitit 2017 nga intervista e zhvilluar me koordinatorin vendor dhe monitorimet e kryera është gjetur se nuk janë zhvilluar mbledhje.

Nga ana tjetër, mbledhjet e GTN realizohen në varësi të rasteve që paraqiten për manaxhim apo ndërhyrje. Gjatë mbledhjeve jo të gjithë aktorët përfshihen aktivisht apo marrin detyrimet përkatëse. Përsa kryesore për ndërhyrje i ngarkohet 2–3 aktorëve ndërsa të tjerët qëndrojnë pasivë.

Që prej vitit 2009 bashkia e Vlorës ka bashkëpunim të ngushtë me qendrën Psiko Sociale Vatra. Rastet e referuara pranë mekanizmit kryesisht i dërgohen qendrës Vatra e cila ofron shërbime ligjore dhe psikologjike falas për viktimat e dhunës në familje. Për rastet kur kërkohet punësim për viktimën, rasti i referohet Zyrës së Punësimit ose Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike pranë bashkisë e cila ka për detyrë të ndihmojë viktimën të aplikojë për ndihmë ekonomike.

**Tabela 11. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve**

Viti	Mbledhjet e GTN
2014	1
2015	2
2016	4
2017	2

*Burimi: Bashkia Vlorë*

Sic shihet nga tabela, megjithëse Vlora ka një numër të lartë të raportimeve të dhunës në familje GTN-ja gjatë vitit 2017 ka trajtuar vetëm 10 raste.

**Tabela 12. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve**

Viti	Mbledhjet e KD
2014	Nuk ka pasur mbledhje
2015	Nuk ka pasur mbledhje
2016	Nuk ka pasur mbledhje
2017	Nuk ka pasur mbledhje

*Burimi: Bashkia Vlorë*

Si pikë e fortë e bashkisë Vlorë vlen të përmendet qëndrueshmëria (mosndërrimi i shpeshtë) e specialistëve që përfaqësojnë institucionet në këto mbledhje dhe prania (ushtrimi i aktivitetit) e organizatave joqeveritare të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

**Tabela 13. Koordinatorit vendor kundër DhBGj**

Viti	Koordinatori Vendor kundër DhBGj
2014	Rezarta Andoni
2015	Rezarta Andoni
2016	Rezarta Andoni
2017	Rezarta Andoni

*Burimi: Bashkia Vlorë*

Pozicioni i koordinatorit vendor për bashkinë e Vlorës është krijuar në nëntor 2009 dhe detyrat janë kryer nga i njëjti person që prej emërimit të saj si Specialiste e Lartë për Dhunën në Familje, ku luan edhe rolin e koordinatorit vendor. Prej vitit 2013 iu shtua detyra e Specialistes së Barazisë Gjinore. Rreth 90% të kohës ia kushton DhF, megjithatë ngarkesa me tre role të ndryshme përbën pengesë për performimin e të gjitha roleve dhe përgjegjësive për secilin prej pozicioneve që mbulohet nga ky person.

Detyrat e koordinatorit vendor janë specifikuar edhe në Rregulloren e re të bashkisë, gjatë periudhës shtator-tetor të vitit 2017. Kjo rregullore është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Vlorë.<sup>8</sup>

Paga e koordinatores përbën edhe përqindjen e buxhetit vjetor që mbështet qendrueshmërinë e këtij pozicioni. Asnjë mundësi tjetër financiare për të mbështetur materiale promovuese nuk është alokuar në buxhetin e bashkisë së Vlorës. Sipas Koordinatorit vendor, nuk ka zë specifik në buxhet dedikuar mirëfunksionimit dhe veprimtarisë së MKR. Kjo përfshihet në buxhetin që i është vendosur në dispozicion planit social të bashkisë Vlorë. Nuk janë zhvilluar trajnime të përbashkëta me anëtarët e MRR. Trajnimi i fundit është zhvilluar gjatë vitit 2014 ku është prezantuar Manuali i Përdorimit për manaxhimin e rasteve të dhunës

Trajnime ku ka marrw pjesw NBGj:

- Kompjuterizimi i të dhënave dhe përdorimi i sistemit online të rasteve të dhunës në familje.; 31.10.2016; Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me UNDP.
- Bilanci i përgjithshëm gjinor në institucionet lokale: njohja dhe realizimi i integritit gjinor në politikat publike.; Maj-Dhjetor 2016 dhe Mars-Dhjetor 2017; Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me CIES Onlus.
- Mbrojtja e fëmijëve viktime të trafikimit dhe shfrytëzimit.; 19.04.2017; Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.
- Mbrojtja e fëmijëve, viktime të trafikimit, viktime të mundshme të trafikimit.; 12.09.2017; Qendra Psiko-Sociale Vatra mbështetur me financim nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terres des Hommes.
- “Protokolli i Mbrojtjes së fëmijëve Nivelet e rrezikut. Vlerësimi fillestar dhe i thelluar”.; 02.11.2017; Qendra Psiko-Sociale Vatra mbështetur me financim nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terres des Hommes.
- Sesioni i trete i trajnimit me teme "Planifikimi dhe menaxhimi i rastit si dhe riintegrimi i femijeve viktime / viktime të mundshme të trafikimit; 16.11.2017; Qendra Psiko-Sociale Vatra mbështetur me financim nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terres des Hommes.
- Komunikimi me një dhunues.; 7-8.12.2017; Organizata Gruaja tek Gruaja dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale.
- Trajnim mbi çështjet e LGBTI për nënpunësit gjinorë në bashkitë e pjesës jugore të Shqipërisë.; 6-7.02.2018; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Diskriminimit të Bazuar në Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor në Shqipëri dhe në Bashkimin Europian”.

Më datë 22.02.2011, me qëllim të ngritjes së Mekanizmit Rajonal të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, është lidhur një marrëveshje bashkëpunimit midis: Bashkisë Vlorë; Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë; Gjykata e Rrethit

---

<sup>8</sup>Bashkia Vlorë <http://bashkiavlore.org/transparenca/rregullorja/>

Gjyqësor Vlorë; Prokuroria e rrethit Vlorë; Zyra e Përmbartimit Vlorë; Mjeku Ligjor; Drejtoria e Shëndetit Publik Vlorë; Spitalit të Përgjithshëm Vlorë; Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë; Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë; Zyra e Punësimit Vlorë; Qendra Psiko-Sociale “Vatra”. Kjo marrëveshje, e cila vazhdon të jetë funksionale përgjatë viteve, është hartuar në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare dhe Shoqatën “Refleksione”.

GTN-ja e bashkisë Vlorë përbëhet nga përfaqësues të institucioneve sipas tabelës më poshtë:

**Tabela 14. GTN-ja e Bashkisë Vlorë ( Kjo sipas MOU 2011)**

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit
<b>Bashkia</b>	Shpëtim Gjika
<b>Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë</b>	Ylli Metko
<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor</b>	Artur Malaj
<b>Prokuroria e Rrethit</b>	Artan Madani
<b>Drejtoria Arsimore Rajonale</b>	Zhyljen Papajorgji
<b>Drejtoria e Shëndetit Publik</b>	Bruna Ndreu
<b>Zyra e Përmbartimit</b>	Elmir Vangjeli
<b>Zyra Rajonale e Punësimit</b>	Mariola Beqiraj
<b>Qendra Psiko-Sociale “Vatra”</b>	Brikena Puka
<b>Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë</b>	Ylber Brahimaj
<b>Spitali Vlorë</b>	Besnik Elezi
<b>Mjeku Ligjor</b>	Ilir Robi

**Tabela 15. MRR-ja e Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2017**

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2017
<b>Bashkia</b>	Dritan Leli
<b>Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë</b>	Gentjan Shehaj
<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor</b>	Skënder Haluci
<b>Prokuroria e Rrethit</b>	Ardian Ylli
<b>Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR)</b>	Albana Hodaj
<b>Drejtoria e Shëndetit Publik</b>	Myzafer Islami
<b>Zyra e Përmbartimit</b>	Fitim Koçiaj
<b>Zyra Rajonale e Punësimit</b>	Marjana Cani
<b>Qendra Psiko-Sociale “Vatra”</b>	Brikena Puka
<b>Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë</b>	Ines Stasa
<b>Spitali Vlorë</b>	Brunilda Mersini
<b>Mjeku Ligjor</b>	Blerim Peli
<b>Qendra Për Zhvillim dhe Promovim Social</b>	Gentiana Xhelili
<b>Qendra “Aulona”</b>	Enela Mone

Nga tabela e mësipërme vihet re ndryshimi i të gjithë drejtuesve të institucioneve shtetërore në harkun kohor të 6 viteve. Vlen gjithashtu të përmendet Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, si e vetmja strukturë e cila nuk ka ndryshuar drejtuesin ekzekutiv dhe pjesëmarrja e dy organizatave të tjera

jofitimprurëse Qendra Për Zhvillim dhe Promovim Social dhe Qendra “Aulona”. Kjo përbën një ndër sfidat e hasura në punën e koordinatorit vendor e cila shpreh se me ndryshimin e shpeshtë të drejtuesve të institucioneve vendore ndryshon edhe përqasja dhe shkalla e bashkëpunimit së tyre mbi çështje të dhunës në familje.

**Tabela 16.** GTN e Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2017

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2017
<b>Bashkia(Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social)</b>	Rezarta Andoni, Irena Stasa
<b>Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë</b>	Silvana Ngresi
<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor</b>	Nuk janë prezent
<b>Prokuroria e Rrethit</b>	Nuk janë prezent
<b>Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR)</b>	Nuk janë prezent
<b>Drejtoria e Shëndetit Publik</b>	Elsa Bimo
<b>Zyra e Përmbarrimit</b>	Nuk janë prezent
<b>Zyra Rajonale e Punësimit</b>	Gjinovefa Xhori
<b>Qendra Psiko-Sociale “Vatra”</b>	Malvina Aliaj, Oliana Manaj
<b>Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë</b>	Eno Koleka
<b>Spitali i Përgjithshëm Vlorë</b>	Nuk janë prezent
<b>Mjeku Ligjor</b>	Nuk janë prezent
<b>Shtëpia e Foshnjës Vlorë</b>	Olta Danaj

Në listën e institucioneve të lartpërmendura vlen të përmendet mungesa e vazhdueshme e pranisë fizike të **Prokurorisë, Gjykatës, DAR, Përmbarrimit, Spitalit të Përgjithshëm Vlorë dhe Mjekut Ligjor.**

Përgjatë vitit 2017, GTN-ja ka trajtuar në mënyrë ndër disiplinare 10 (dhjetë) raste të dhunës në familje, për të cilat është ndërhyrë në kohën e duhur me shërbime multidisiplinare. Konkretisht: një rast jeton me vajzën e saj e mbështetur nga bashkia me bonus social. Rasti në fjalë është pjesë e familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike; katër prej tyre jetojnë së bashku me fëmijët e tyre; një rast qendron e akomoduar pranë Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës së bashku me 3 fëmijët e saj; një rast është rikthyer me bashkëshortin pas zgjidhjes së konfliktit midis tyre. Ndërkohë që një prej rasteve të trajtuara nuk është mbyllur me sukses si pasojë e refuzimit të ndihmës dhe vendimit për t’u kthyer pranë familjes së origjinës, e cila nga frika e paragjykitimit dhe diskriminimit të komunitetit, ka detyruar rastin të refuzojë ndihmën e ofruar.

Specialistët e përfaqësuesve anëtare të MRR kanë ofruar shërbimet përkatëse të nevojshme për ndërhyrjen dhe manaxhimin e rasteve, si ndërmjetësim për punësim; ndërmjetësim për lehtësim në akses dhe ofrim shërbimesh; mundësimi në kohë i certifikatave personale/familjare për rastet viktime të dhunës; hartimi i kërkesë padive; strehim urgjent pranë Strehëzës “Vatra” deri në momentin e strehimit të qëndrueshëm pranë Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës; shërbime ligjore dhe psikologjike falas për viktimat; akomodim emergjent i fëmijëve në institucione të përkujdesit etj.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile është i rregullt dhe i ngushtë. Qendra “Vatra” është qendër e specializuar në ofrimin e shërbimeve ligjore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje. Qendra “Aulona” ofron shërbime mjekësore-gjinekologjike falas për viktimat e dhunës në familje. Të dyja qendrat kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë trajnime për çështje të dhunës lidhur me aspektin mjekësor, aksesin në drejtësi, mbi mirëqenien e shëndetit psikologjik, sensibilizim etj. Në këto trajnime kanë marrë pjesë edhe anëtarë të MRR dhe GTN-së.

Bashkëpunimi me Qendrën Psiko-Sociale “Vatra” është shumë i ngushtë, si e vetmja organizatë në Vlorë që ofron shërbime të specializuara falas për viktimat e dhunës në familje. Duhet theksuar që prej vitit 2011 koordinatori punon si strukturë e bashkisë e atashuar pranë Qendrës Vatra. Prej vitit 2011 bashkia Vlorë mbështet financiarisht Qendrën Vatra me qera për zyra dhe shpenzime operative (energji elektrike, ujë dhe komunikim).

Në momentin e parë që koordinatori vlerëson së rasti paraqet nevojën për tu mbështetur me shërbime ligjore dhe psikologjike, ajo e referon pranë qendrës. Gjithashtu, bashkëpunimi konsiston në:

1. Asistencë psikologjike i rasteve viktime të dhunës në familje në Komisariat
2. Vlerësimin e nevojave të rastit nga grupi multidisiplinar në përbërje të së cilit është avokati dhe psikologu i qendrës;
3. Akomodimi pranë strehëzës Vatra i rasteve (përgjithësisht me fëmijë) me nevoja emergjente për strehim;
4. Shoqërim me punonjës social/psikolog i rasteve

Përgjatë vitit 2017, Vatra ka asistuar me shërbime ligjore, psikologjike, formim profesional, trajnim në punë dhe ndërmjetësim për punësim 237 viktime të dhunës në familje, prej të cilave 212 raste të reja dhe 85 fëmijët e tyre të asistuar për herë të parë gjatë vitit 2017, konkretisht 190 vajza dhe gra, 9 djem dhe burra dhe 16 dhunues. Përgjatë kësaj periudhe koordinatori ka referuar për asistencë ligjore dhe psikologjike 12 raste viktime të dhunës në familje pranë Qendrës Vatra.

Bashkëpunimi me policinë ka qenë i ndërmjetëm. Vlen të përmendet kontributi dhe bashkëpunimi me Sektorin e Dhunës në Familje dhe të të Miturve edhe pse nga ana e inspektorëve të zonës nuk ka pasur referime të rasteve të viktimeve të dhunës në kohë reale. Sektori i dhunës në familje dhe të të miturve, strukturë e brendshme e policisë, ka komunikuar nëpërmjet email-it në mënyrë periodike, njoftimet për shtyp për çdo muaj gjatë vitit 2017. Nga kjo strukturë, koordinatori vendor, i janë vendosur në dispozicion analizat 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore. Në bazë të analizës vjetore, koordinatori vendor bën rakordimin e rasteve (p.sh. sa raste janë pajisur me UMM/UM; sa raste kanë shkuar për ndjekje penale në prokurori; sa rasteve u është refuzuar kërkesa për UMM etj).

Gjatë mbledhjeve të GTN specialistja e policisë është gjithmonë e pranishme. Gjatë bisedës me koordinatoren vendore kundër dhunës në familje ajo sjell ndërmend rastin e një nëne me 3 fëmijë, viktimë e dhunës, e menaxhuar me sukses nga GTN. Pas mbledhjes së GTN dhe vlerësimit të nevojave, policia ka bërë të mundur transportin e gruas dhe fëmijëve të saj drejt Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Viktimeve të Dhunës në Familje në Tiranë në muajin shtator 2017. Rasti në fjalë është paraqitur në Policinë e Vlorës me 3 fëmijët e saj e frikësuar si pasojë e dhunës së ushtruar prej bashkëshortit të saj, dhunues i hershëm, i alkoolizuar. Deri në momentin e pajisjes së



rastit me Urdhër Mbrojtje, së bashku me 3 fëmijët, ata janë strehuar për disa ditë pranë Qendrës Vatra ku janë mbështetur me paketën e plotë të shërbimeve. Me pajisjen e rastit me Urdhër Mbrojtje, ajo është shoqëruar nga Policia drejt QKTVDH në Tiranë. Aktualisht rasti dhe 3 fëmijët vazhdojnë të jenë të akomoduar pranë QKTVDH. Është mbështetur me asistencë ligjore dhe shoqëruar gjatë procesit të zgjidhjes së martesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Fëmijët ndjekin kopështin dhe shkollën ndërkohë që gruaja është punësuar në fasoneri.

Bashkëpunimi me Shërbimin Social Rajonal mbetet i vakët. Ky institucion ndihmon në mbështetjen dhe ndërmjetësimin institucional në rangje të larta. Kjo ndodh pasi ShSR ka kompetencën t'i kërkojë ndihmë Shërbimit Social Shtetëror Tiranë për akomodimin e rasteve të dhunës në qendra rezidenciale shtetërore. Duhet sqaruar se gjatë mbledhjeve të GTN, ky institucion është gjithmonë i pranishëm por nuk ndërmarrin iniciativa për mbështetjen e rasteve të dhunës në familje apo formave të tjera të dhunës. E vetmja gjë që Shërbimi Social Rajonal raporton se bën është referimi i rasteve që paraqiten për ndihmë, te ofruesit e shërbimeve.

Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur referime për raste të viktimave drejt Zyrës së Punësimit. Zyra e Punësimit ndërkohë është e hapur të parashtrijë të gjitha ofertat e tregut të punës në përputhje me nevojat, kapacitetet dhe kërkesat e rasteve të referuara për ndërmjetësim për punësim.

Në lidhje me zyrën e përmbarimit, nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi/shkëmbim informacioni. Nuk janë trajtuar/manaxhuar raste që kanë pasur nevojë për ndërhyrjen e zyrës së përmbarimit. Gjithashtu, ata nuk kanë qenë prezent në asnjë takim.

Bashkëpunimi me Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje në Tiranë është i mirë. Megjithatë duhet përmendur se QKTVDH nuk është plotësisht e hapur për pritjen e viktimave të dhunës. Specifikisht, sipas koordinatorit vendor, ka ndodhur që QKTVDH ka refuzuar akomodimin urgjent sënjë prej viktimave të dhunës dhe djalit të saj si pasojë e mospajisjes së rastit me Urdhër Mbrojtje, ndërkohë që rasti pohonte se ndihej e rrezikuar për jetën dhe pa mbështetjen nga familjarët, duke shkaktuar probleme në zgjidhjen e rastit.

Në bashkëpunim me Qendrën “Vatra” dhe me policinë, gjatë vitit 2017, është ndërmjetësuar për akomodimin e një rasti pranë kësaj qendre. Bashkëpunimi ka vazhduar edhe duke i mundësuar qendrës tërheqjen e çertifikatave personale/familjare të rastit në fjalë në Gjendjen Civile Vlorë dhe kartelat mjekësore të 3 fëmijëve të saj.

Për vitin 2016 dhe 2017 janë akorduar dy bonuse sociale nga bashkia e Vlorës për raste të grave viktimat të dhunës në familje. Një prej rasteve është akomoduar prej muajit Janar 2017 pranë Godinave të Plazhit të Vjetër Vlorë (aset i Bashkisë Vlorë) dhe një rast është mbështetur me pagesën e një apartamenti me qera për 12 muaj. Megjithatë, nga monitorimi vihet në dukje se procesi i dhënies së bonuseve mund të thjeshtohet më tej për të lehtësuar përfitueset. Për të përfituar nga skemave e mbështetjes me bonuse sociale për qera rastet duhet t'i drejtohen specialistit përkatës në Bashki, i cili pajis rastin me listën e dokumentacionit që duhet paraqitur. Në listën e këtyre dokumentacioneve, ekzistojnë dokumenta që kërkojnë kohë dhe fonde për tu përgatitur. Vlen të përmendet domosdoshmëria për vendosjen e një kontrate noteriale midis qeradhënësit dhe qeramarrësit (viktimit të dhunës), vlera monetare e së cilës është e paparballueshme.

Gjatë vitit 2017 bashkëpunimi me njësitë administrative mbetet i moderuar. Edhe pse koordinatori vendor u ka kërkuar administratorëve socialë t'i referojë raste sipas të dhënave të mbledhura nuk rezulton se këta të fundit kanë marrë pjesë në mbledhje apo të kenë referuar raste konkrete.

Në lidhje me përmirësimin e kapaciteteve të koordinatorit vendor, ajo ka marrë pjesë në trajnime aktivitete dhe konferenca të shumta gjatë vitit 2017. Megjithatë shpreh nevojën për trajnime të vazhdueshme.

Në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të sistemit dhe përditësimit të të dhënave, të dhënat hidhen në varësi të angazhimeve ditore. Përdorimi i sistemit nuk është i përditshëm, por koordinatori sigurohet që në fund të çdo muaji të gjitha rastet të jenë të evidentuara në sistem. Mungesa e kohës fizike për hedhjen e përditshme të të dhënave si pasojë e detyrave të mbingarkuara, pavlefshmëria e Websit-it (skadencia e çertifikatës apo problem teknike) janë disa nga sfidat e hasura gjatë përdorimit gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2017 koordinatorja nuk ka ndarë asnjë raportim mbi punën e GTN dhe rastet e manaxhuara me MRR sepse nuk është zhvilluar asnjë mbledhje e këtij të fundit. Për periudhën Janar-Dhjetor 2017 ajo ka raportuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi veprimtarinë vjetore të Njesisë për Dhunën në Familje.

### *Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.*

Shërbimi i Provës dhe Gjykata janë institucione të cilët nuk përfaqësohen asnjëherë në mbledhjet e GTN. Përveç kësaj mungon edhe komunikimi midis koordinatorit dhe strukturës së Shërbimit të Provës (koordinatori nuk është në dijeni të rasteve të referuara të dhunuesve për tu trajtuar me programe të tilla). Koordinatori nuk ka informacion mbi format e aplikuar të shërbimeve apo kohezgjatjen e shërbimit.

Çdo UMM që del nga Gjykata vjen dorazi nëpërmjet postës pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale. Në momentin e dorëzimit firmosen nga koordinatori vendor. Megjithatë, ka pasur raste të mos dërgimit në kohë të UMM-ve që kanë çenuar qëllimin e emergjencës së tyre.

Gjykata e rrethit të Vlorës i publikon të dhënat e saj mbi rastet e ndjekura në gjykatë në mënyrë të detajuar në faqen e saj në internet. Këto të dhëna janë të ndara sipas veprës penale apo civile, sipas kohëzgjatjes së marrjes së vendimit si edhe nëse rastet janë të paraqitura rishitaz apo të mbartura nga vitet e kaluara. Këto të dhëna nuk janë të disagreguara sipas gjinisë dhe nuk ka detaje sa i përket çështjeve të dhunës në familje, të cilat mbledhen kryesisht nga drejtoria e policisë.

Duhet përmendur gjithashtu se mbledhja e të dhënave nga shërbimi i provës nuk bëhet në mënyrë të disagreguar sipas gjinisë apo sipas llojit të veprës penale. Të dhënat që janë të aksesueshme nga shërbimi i provës japin vetëm numrin total të personave që kanë marrë dënime alternative, pa vendosur detaje mbi llojin e veprës së kryer apo të ndarë sipas gjinisë. Kjo e vështirëson identifikimin e të dhënave mbi personat që marrin dënime alternative. Për shembull nuk është e

mundur të kuptojmë nga statistikat e publikuara nga shërbimi i provës sa prej personave janë dënuar për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje. Përmbushja e objektivit 3.3 paraqitet më sfiduesja pasi është edhe objektivi specifik më pak i respektuar në implementimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore.

**Tabela 17. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Vlorë**

Vitet	Nr. i dhunuesve
2014	88
2015	113
2016	125
2017	84

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë

### **Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Vlorë**

Në bashkinë e Vlorës janë bërë disa përpjekje për zbatimin qëllimit strategji 3, të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore (2016-2020) përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese, trajnimeve të punonjësve përgjegjës për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Janë trajtuar disa raste me sukses sa i përket mekanizmit të referimit. Në bazë të monitorimit të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Vlorës më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Vlorë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Bashkia Vlorë duhet të bëjë përpjekje që në buxhetin e vitit 2018 të alokojë fonde të mjaftueshme dhe të planifikojë ndërtimin e banesave sociale për strehim dhe akomodim të rasteve të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje
- Bashkia Vlorë duhet të parashikojë një zë të veçantë në buxhetin e bashkisë për mirëfunksionimin e mekanizmit të referimit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve të mekanizmit.
- Nevojitet lehtësim i procedurave për përfitimin e bonuseve sociale nga bashkia Vlorë.
- Në bashkinë Vlorë duhet ndërtuar një qendër emergjence për akomodimin e rasteve që paraqesin nevoja urgjente si dhe një linjë këshillimi dhe qendër rehabilitimi për dhunuesit pasi në bashkinë e Vlorës nuk ofrohen shërbime këshillimi dhe nuk ka as organizata jo qeveritare që mund të ofrojnë këtë shërbim.
- Në bashkinë e Vlorës duhet të ofrohen shërbime të specializuara për trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje për rastet kur viktimat përballen me probleme të shëndetit mendor.
- Sistemi online për hedhjen e të dhënave duhet të përmirësohet.
- Mbingarkesa e koordinatori vendor duhet të merret vetëm më rastet e dhunës në familje dhe jo me shumë detyra të tjera. Ky koordinator ka shumë punë për të bërë duke qënë se rastet e raportimeve në Vlorë janë të shumta. Përveç kësaj duhet të koordinojë institucionet që përgjigjja ndaj raste të dhunës në familje të jetë e menjëherëshme dhe e mirëkoordinuar. Psh. duhet të rregullojë sistemin e referimit të rasteve nga policia, gjykatat etj. Është e

rëndësishme të institucionalizohet bashkëpunimi me policinë në mënyrë që rastet të referohen në mënyrë të rregullt dhe të ketë reagim sa më të shpejtë në rastet emergjente. Që koordinatori duhet të ketë vetëm këtë detyrë të specializuar e tregon edhe fakti që rastet e ndjekura në mënyrë ndërdisiplinore për vitin 2017 janë mjaft të ulëta në krahasim me rastet e raportuara pranë organeve përkatëse për të njëjtin vit. Kjo paraqet domosdoshmërinë e përmirësimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse në mekanizmin e referimit.

## Aneksë

### *Aneksi 1- Detyrat e koordinatorit për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje*

Detyrat e njësisë për dhunën në familje dhe barazinë gjinore (Burimi: Rregullore e Bashkisë Vlorë, <http://bashkiavlore.org/transparenca/rregullorja/>)

Njësia për dhunën në familje dhe barazinë gjinore:

- a. Specialisti i Njesisë për dhunën në familje dhe barazinë gjinore është punonjës me statusin e nëpunësit civil dhe ka epror direkt Drejtorin e Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social.
- b. Mund të kërkojë ngritjen e kërkesë-padisë në lidhje me kërkesën për Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje me pëlqimin e viktimës.
- c. Bën monitorimin e rasteve të dhunës në familje duke asistuar në seancat gjyqësore.
- d. Realizon hedhjen e të dhënave në sistemin databazë.
- e. Bën sensibilizim dhe ndërgjegjësim të komunitetit për fenomenin e dhunës në familje dhe barazisë gjinore.

### *Aneksi 2- Detyrat e të gjithë anëtarëve që kanë nëshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit si pjestarë të Mekanizmit të Rreferimit kundërDhues me Bazë Gjinore*

#### **A. Bashkia e Vlorës ka këto përgjegjësi dhe detyrime specifike:**

- *Të luajë rol drejtues në ngritjen, konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e mekanizmit referues për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.* Në këtë kuadër, bashkia e Vlorës është angazhuar tashmë për ndërtimin e këtij mekanizmi që po të formalizohet përmes kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi. Po në këtë kuadër, pranë bashkisë është emëruar edhe Specialistja e lartë për Dhunën në Familje, e cila do të luajë edhe rolin e Koordinatorës vendore. *Znj. Rezarta Andoni*, e emëruar në këtë pozicion, është e gatshme të informojë të gjitha institucionet/aktorët e interesuar përsa i takon sistemit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje. Ajo mund të kontaktohet çdo ditë nga ora 08:00 deri në orën 16.00 nëpërmjet nr të telefonit +35533239984, adresës së e-mailit [r-andoni@hotmail.com](mailto:r-andoni@hotmail.com) ose mund të takohet direkt pranë Zyrës në Bashki, ose tek Qendra Psiko-Sociale “Vatra” Vlorë.
- *Të grumbullojë të dhëna të standartizuara mbi dhunën në familje dhe t’ua shpërndajë ato palëve të duhura.* Bashkia merr përsipër që, bazuar në të gjitha Marrëveshjet, Aktet Nënligjore në vijim të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare” (i ndryshuar), në konsultim me të gjitha institucionet përkatëse si dhe me Prefekturën, të hartojë një formular Tip që do të shërbejë për mbledhjen e të dhënave të standartizuara për rastet e dhunës në familje. Aktualisht, meqenëse në Bashki është i instaluar edhe sistemi elektronik i mbledhjes së të dhënave për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, ky formular është i gatshëm dhe thjesht mund të dërgohet për mendim për mbledhjen e sugjerimeve për përmirësimin e tij. Këto të dhëna, Koordinatorja vendore do t’i grumbullojë nëpërmjet komunikimit me email, nga çdo institucion palë e kësaj marrëveshjeje, por edhe më gjerë, *brenda pesë ditëshit të parë të çdo muaji*, si dhe do t’i shpërndajë tek të gjithë aktorët përgjegjës në formën e një raportimi të thjeshtë, duke ruajtur të gjithë parametrat e raportimit dhe konfidencialitetin për rastet e dhunës në familje, *jo më*

vonë se data 10 e çdo muaji. Koordinatorja vendore ka përgjegjësinë e dërgimit të një e-maili kujtesë dhe të konfirmimit të marrjes së të dhënave nga çdo institucion partner.

- *Të përforcojë zbatimin në nivel lokal të buxheteve të përcaktuara për ndihmën ligjore pa pagesë për viktimat e dhunës në familje; Të angazhohet në ngritjen e strukturave të shërbimeve sociale për rastet e dhunës në familje; Të instalojë linja telefonike rajonale pa pagesë për 24 orë, të cilat më pas krijojnë lidhjen me njësitë vendore, me policinë, me njësitë e urgjencës mjekësore dhe me OJF-të për të koordinuar veprimet.* Në përmbushje të këtyre detyrimeve, për vitin 2011, bashkia e Vlorës ka marrë përsipër dhe ka hapur tashmë Zyrën për Dhunën në Familje, ka futur në strukturë Koordinatorës vendore, ka ndërmarrë një sërë hapash për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit referues, si edhe mbulon një pjesë të kostove për shërbimin telefonik që ofron Qendra Psiko-Sociale “Vatra”.
- *Të ngrejë qendra sociale dhe rehabilitimi për viktimat dhe dhunuesit, dhe të koordinojë përpjekjet me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat respektive; Sërish në këtë drjetim vlen të përmendet bashkëpunimi i deri-tanishëm me Qendrën Psiko-Sociale Vatra.*
- *Të ngrejë strukturat e nevojshme dhe të identifikojë personat që do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.* Me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi ligjor, bashkia merr përsipër organizimin dhe lehtësimin e mbledhjeve të rregullta, çdo tre muaj, me Komitetin Drejtues. Mbledhjet do të zhvillohen në ambjentet e Bashkisë, në bazë të një ftese dhe rendi dite të caktuar, të cilat do të dërgohen tek çdo institucion jo më vonë se shtatë ditë përpara datës së propozuar për organizimin e mbledhjes. Proçes-verbali i mbledhjeve së bashku dhe me çdo vendim që mund të merret, do të qarkullohen nga Koordinatorja vendore tek çdo institucion pjesëmarrës në komitetin drejtues. Ndërkohë, po në bazë tre mujore, bashkia, në emër të Komitetit Drejtues, merr përsipër të raportojë tek Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta mbi veprimtarinë e këtij Komiteti, problematikën e dhunës në familje në Vlorë, si edhe të paraqesë në këtë raport propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga institucionet qendrore. Në nivel të menaxhimit të rastit, bashkia merr përsipër organizimin në mënyrë të rregullt të mbledhjeve konsultative të GTN (i cili ngrihet me vendim të Komitetit Drejtues dhe përbëhet nga specialistë përkatës të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, pranë çdo institucioni antar të reagimit të koordinuar). Këto mbledhje do jenë të rregullta, çdo muaj, si dhe të jashtëzakonshme, pra në varësi të rasteve që mund të paraqiten. Sërish Koordinatorja vendore ka përgjegjësinë për mbajtjen dhe qarkullimin e minutave të mbledhjeve tek çdo specialist dhe institucion antar i këtij grupi.
- *Të hartojë Marrëveshjet e Bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve përkatëse dhe institucionet e tjera shtetërore.* Paralelisht dhe në funksion të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, bashkia e Vlorës do të shqyrtojë në mënyrë të vazhdueshme mundësinë për përfshirjen e një sërë aktorësh të tjerë në mekanizmit e reagimit të koordinuar si dhe hartimin e marrëveshjeve specifike, bazuar në situatat që mund të paraqiten. Pjesë e këtij detyrimi, do të jetë edhe vlerësimi i herëpashershëm në mënyrë periodike, vjetore, i të gjithë aktorëve të mundshëm për t’u përfshirë në këtë mekanizëm.
- *Të përgatisë dhe paraqesë kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, apo për urdhër mbrojtjeje për të mitur.* Në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar), Specialistja e Dhunës në Familje, që është njëkohësisht dhe Koordinatorja vendore asiston

viktimat e dhunës në familje në përgatitjen e kërkesës për urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes, apo për urdhër mbrojtjeje për të mitur, në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki dhe gjithashtu në bashkëpunim me qendrën Psiko-Sociale Vatra .

- *Ta informojë viktimën ose personin që e shoqëron atë mbi shërbimet ekzistuese sociale dhe ta shoqërojë mundësisht atë për në qendrat e duhura, duke siguruar transportin nëse është e nevojshme; Informimi i rasteve të dhunës në familje që mund të paraqiten pranë bashkisë do të kryhet nga Koordinatorja vendore znj. Rezarta Andoni.*

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve ligjore të Bashkisë, të gjitha palët e tjera në këtë Marrëveshje bien dakort:

- a) Të angazhohen në nivel vendim-marrjeje për të qenë pjesë e mbledhjeve të rregullta të Komitetit Drejtues “Për bashkërendimin e institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje”, si dhe të bien dakort për një kalendar paraprak të organizimit të këtyre mbledhjeve.
- b) Të caktojnë të paktën një specialist/e që në mënyrë specifike do të merret me trajtimin e rasteve të dhunës në familje si dhe që do të jetë pjesë e GTN, që do të ngrihet me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Caktimi i specialistit të bëhet me shkresë zyrtare, bazuar në titullin/pozicionin e punës dhe të dhënat përkatëse t’i vihen në dispozicion bashkisë jo më vonë se pesë ditë nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje; Të dhënat e vëna në dispozicion duhet të përmbajnë: emrin e personit/ave, nr telefoni, faks, celular, adresë e-maili, adresë postare, si dhe oraret më të përshtatshme për kontaktim të rregullt. Të gjithë personat e caktuar duhet të jenë në dijeni dhe të kenë rënë dakort me angazhimin e tyre pavarësisht orarit zyrtar të punës;
- c) Të sugjerojnë formate të përshtatshme, të krahasueshme edhe me formatet që aktualisht përdorin (në rast se përdorin) për mbledhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje;
- d) Të venë në dispozicion informacionin e kërkuar për rastet e dhunës në familje që trajtojnë çdo muaj, jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës. Për këtë arsye, çdo institucion ka detyrimin të përcaktojë një person përkatës si pikë kontakti për mbledhjen dhe dërgimin e këtij informacioni. Emri dhe kontaktet e këtij personi duhet të vihen në dispozicion të Bashkisë, jo më vonë se dhjetë ditë nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Informacioni mund të dërgohet tek Koordinatorja vendore nëpërmjet adresës së e-mailit [r-andoni@hotmail.com](mailto:r-andoni@hotmail.com) ose mund t’i dorëzohet dorazi asaj, në bazë të një kontaktimi paraprak;
- e) Të konfirmojnë me shkrim marrjen e raportimit mujor përkatës në lidhje me rastet e dhunës në familje, si dhe marrjen e minutave të takimit në nivel vendim-marrësish apo në nivel menaxhim rasti, në adresën e e-mailit të sipërpërmendur;
- f) Të adresojnë pranë bashkisë kërkesat për mbështetjen me shërbime specifike të rasteve të ndryshme të dhunës në familje, sipas nevojës dhe shërbimeve që mund të mbulojë bashkia;
- g) Të sugjerojnë mënyra për nxitjen e bashkëpunimit mes anëtarëve të reagimit të koordinuar, si dhe të ndihmojnë në identifikimin e antarëve të tjerë të mundshëm (bazuar edhe në eksperiencat e tyre bashkëpunuese).

**B. Drejtoria e Policisë Qarkut Vlorë, ka këto detyrime dhe përgjegjësi specifike:**

- *Të reagojë menjëherë ndaj të gjitha thirrjeve për dhunë në familje.* Paralelisht me të gjitha njoftimet që mund të marrë në numrin e telefonit 129, ose në numrat e tjerë që mund të disponojë për këtë qëllim, Drejtoria e Policisë, ka detyrim të reagojë me prioritet kundrejt të gjitha thirrjeve që mund të marrë për dhunë në familje, veçanërisht nga antarët e mekanizmit referues, nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, apo nga Koordinatorja vendore.
- *T’i intervistojë viktimat të ndara nga autorët e dhunës dhe të tjerët;* në këtë kuadër, intervistimi do të kryhet në bazë të të gjitha procedurave standarte të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Drejtoria e Policisë, mund të mbështetet edhe tek burimet ekzistuese mes antarëve të tjerë të mekanizmit referues (njerëzore apo infrastrukturë).
- *Të mbledhë prova për incidentin në bazë të procedurave standarte të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përmes fotove, intervistave me dëshmitarët dhe me anë të teknikave të tjera investigative;* sërish në këtë kuadër, personeli i policisë mund të mbështetet edhe tek antarët e tjerë të mekanizmit referues dhe njëkohësisht duhet të verë në dispozicion informacionin e mbledhur sipas nevojës tek antarët e tjerë (veçanërisht prokurori dhe gjykatë). Në çdo rast, punonjësit e policisë duhet t’ju japin udhëzimet përkatëse antarëve të tjerë të GTN, lidhur me ruajtjen e padëmtuar të provave në vendin e ngjarjes.
- *Të plotësojë dokumentimin e të hollësive të rastit;* Këtu mund të përdoren formularët Tip të policisë, miratuar edhe nga Ministria e Brendshme si dhe përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
- *Ta transportojë viktimën në një vend të sigurt ose ta largojë keqbërësin për të garantuar sigurinë e viktimës.* Këtu duhet të merret shumë në konsideratë siguria e viktimës dhe hapat duhet të kryhen në bashkëpunim dhe konsultim me Koordinatorin vendore, pa përjashtuar edhe aktorët e tjerë antarë të reagimit të koordinuar. Transportimi sipas rastit, mund të lehtësohet edhe nga antarët e tjerë të mekanizmit referues.
- *Të iniciojë koordinimin e GTN, nëse kontaktohet e para.* Pavarësisht nëse e merr telefonatën e para apo njoftohet nga antarë të tjerë të mekanizmit referues, paralelisht me shkuarjen në vendngjarje dhe ndërhyrjen, policia duhet të marrë masa të menjëherëshme për të njoftuar antarët përgjegjës të reagimit të koordinuar (që veprojnë në nivel menaxhim rasti), pra Koordinatorin vendore dhe antarët e tjerë sipas rastit (shpjeguar në paragrafët më sipër të kësaj marrëveshjeje).
- *Ta informojë viktimën, ta ndihmojë në plotësimin e kërkesës si dhe në depozitimin e dosjes për marrjen e një urdhri mbrojtjeje, si dhe ta referojë atë tek antarët e tjerë të mekanizmit, për shërbime të mëtejshme.* Ky hap është shumë i rëndësishëm dhe paralelisht me sigurimin e jetës së viktimës, ajo duhet të informohet për mundësitë që ka në bazë të ligjit (pra nuk duhet pritur të bëhet kjo gjë vetëm nëse viktimja e kërkon, pasi duhet marrë në konsideratë fakti që viktimja mund të mos ketë dijeni për masat ligjore ekzistuese). Njëkohësisht punonjësit e policisë duhet t’i ofrojnë asaj mbështetjen dhe ndihmën përkatëse për hartimin e kërkesës dhe plotësimin e dosjes për urdhër mbrojtjeje dhe duhet të merren me dorëzimin e kësaj dosjeje. Referimi tek shërbimet e tjera që ofrojnë antarët e reagimit të koordinuar është sërish i rëndësishëm dhe ndjek dy hapat e para. Në varësi të rastit, policia mund të bashkëpunojë me Koordinatorin vendore.
- *Të reagojë dhe të ndërhyjë ndaj shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes; Të nisë kontaktin me prokurorët për shkeljen e urdhrave; Të reagojë ndaj çdo raportimi të shkeljes së*



*UM/UMM-së në kohën e duhur për të garantuar sigurinë e viktimave; Policia duhet të ndërhyjë dhe përgjigjet në çdo kohë në rast konstatimi apo informimi për shkeljen e UMM apo UM, si në rastin kur vihet në dijeni direkt nga viktimja, edhe në rastin kur informohet nga aktorët përgjegjës antarë të mekanizmit referues apo edhe më gjerë. Policia duhet të marrë të gjitha masat për të kontaktuar me prokurorët për shkeljet e urdhërave përkatës, duke telefonuar fillimisht prokurorin e gatshëm, pranë Prokurorisë së Rrethit Vlorë, sipas grafikut mujor të gadishmërisë, të vënë në dispozicion nga ky organ Drejtorisë së Policisë Vlorë. Po kështu, policia duhet të shoqërojë viktimën dhe punonjësit përkatës të Zyrës së Përmbarrimit gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit për UMM apo UM, me qëllim garantimin e sigurisë së viktimës si edhe të institucioneve të tjera antare të reagimit të koordinuar.*

- *Të plotësojë dhe të dërgojë dokumentacionin për çështjen penale kur është rasti për përgjegjësi penale; Paralelisht me sa më sipër, policia duhet të punojë edhe për plotësimin e dokumentacionit për hapjen e një çështjeje penale, nëse është e mundur, si dhe dërgimin e këtij dokumentacioni përkatës në Prokurori. Në çdo rast, vlerësimi i situatës bëhet duke u nisur nga nocioni i viktimës në qendër, duke synuar kështu garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e të drejtave të saj. Në kryerjen e kësaj detyre, policia respekton parimin e barazisë së shtetasve, duke mos diskriminuar për asnjë shkak, veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, prejardhjes etnike, gjendjes civile apo faktit që vepra ka ndodhur në kuadrin familjar.*
- *Të vlerësojë nevojën për kujdes mjekësor dhe nevoja të tjera urgjente dhe të kryejë transportin nëse është e nevojshme. Paralelisht me veprimet e përshkruara më sipër, duke bashkëpunuar edhe me antarët e tjerë të mekanizmit referues, apo në rast kërkese nga viktimja, policia duhet të vlerësojë nevojën për kujdes mjekësor si dhe duhet të mundësojë transportimin e viktimës në qendrën spitalore përkatëse. Në rast konstatimi të një nevoje të tillë, paraprakisht policia duhet të komunikojë me Drejtorin e Qendrës Shëndetsore apo të Spitalit Vlorë.*
- *Të garantojë që i gjithë personeli i policisë të trajnohet në reagimin ndaj dhunës në familje, ku përfshihen: punonjësit, oficerët dhe të gjithë reaguesit. Në kuadër të ndërhyrjeve të mësipërme, policia duhet të informojë vazhdimisht Koordinatorin vendore për nevojat që mund të kenë/apo mund të identifikojnë, për trajnim me qëllim përmirësimin e njohurive për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Po kështu, herë pas here policia duhet të jetë e gatshme t'ju nënshtrohet vlerësimeve për identifikimin e nevojave për trajnim, qofshin këto nga Ministria e Brendshme, apo edhe të iniciuara nga sistemi i reagimit të koordinuar.*

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë, të gjitha palët e tjera në këtë marrëveshje bien dakort:

- a. Të njoftojnë në çdo kohë dhe sipas rastit policinë për çdo denoncim dhe nevojë për ndërhyrje në rastet e dhunës në familje;
- b. Të koordinojnë veprimet bashkarisht për të shkuar në vendngjarje;
- c. Të lehtësojnë punën e organeve të policisë nëpërmjet mbështetjes me burime të ndryshme në dispozicion, në funksion të menaxhimit të rastit (burime njerëzore, transport, infrastrukturë, etj);
- d. Të identifikojnë, adresojnë dhe mbështesin policinë në lidhje me nevojat e ndryshme për trajnimin e stafit përkatës për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

### **C. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka këto përgjegjësi dhe detyrime specifike:**

- *Të lëshojë urdhra mbrojtjeje në kohën e duhur për të garantuar sigurinë e viktimës.* Në këtë kuadër, Gjykata e Vlorës merr masa për të shqyrtuar kërkesat për urdhëra mbrojtjeje në çdo kohë dhe bazuar në parashikimet në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare” (i ndryshuar). Për rastet jashtë orarit zyrtar të punës, kjo Gjykatë organizon shërbimin e gjyqtarit/es së gatshëm/e për shqyrtimin e kërkesave për UMM. Këto kërkesa do të merren në shqyrtim dhe do të lëshohen urdhërat përkatës bazuar në ligjin në fuqi.
- *Të ndihmojë viktimat në kuptimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të proceseve të gjykatës.* Në këtë kuadër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë duhet të marrë të gjitha masat me qëllim informimin e viktimave, vënien në dispozicion të formularëve të caktuar (kërkesë-padive për urdhërat mbrojtës), si dhe vënien në dispozicion të tyre të një informacioni shpjegues për hapat dhe procedurat që mund dhe duhet të ndjekin. Organizimi i brendshëm i Gjykatës për depozitimin e kërkesës për urdhëra mbrojtjeje duhet parë me prioritet dhe duke respektuar urgjencën e rastit. Në këtë drejtim, Gjykata mund dhe duhet të bashkëpunojë edhe me anëtarët e tjerë të sistemit të reagimit të koordinuar, me qëllim informimin e sa më shumë qytetarëve. Në mënyrë specifike, informacioni i ofruar duhet të përmbajë të dhëna për orarin, vendin si dhe mënyrën se si mund të gjenden dhe plotësohen formatet për kërkesën për lëshimin e urdhërave mbrojtës.
- *Të ofrojë mbrojtjen e plotë të mundshme për viktimat e dhunës në familje.* Kjo nënkupton një shikim sa më të detajuar të kërkesës së paraqitur për urdhëra mbrojtës, me synimin arritjen e sigurisë së viktimës dhe në të njëjtën kohë dhënien e mundësisë për mbrojtjen e plotë të saj.
- *Të rrisë masat e sigurisë në godinë,* për të garantuar mbrojtje për viktimën/at, gjyqtarin/en, si dhe palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin e shqyrtimit të kërkesave për UM dhe UMM.
- *Të marrë pjesë në Reagimin e Koordinuar të Komunitetit dhe të sigurojë informacionin kyç dhe drejtimin për anëtarët e tjerë, për të garantuar procedura efikase brenda gjykatës për viktimat;* Në këtë kuadër, pjesëmarrja e një përfaqësuesi të Gjykatës në mbledhjet në nivel vendim-marrjeje të reagimit të koordinuar të komunitetit, nuk duhet parë me syrin e shkeljes së paanshmërisë së këtij institucioni, por me synimin e përmirësimit të shërbimeve të ofruara kundrejt viktimave të dhunës në familje, si dhe me idenë e rritjes së aksesit të këtyre viktimave (veçanërisht grave), në sistemin e drejtësisë.

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të gjitha palët e tjera në këtë marrëveshje bien dakort:

- a. Të informojnë të gjitha viktimat e dhunës në familje, por edhe komunitetin më gjerë, për mundësitë dhe mënyrën e kontaktimit të personave/strukturave përkatëse në rastin e nevojës për dorëzimin e kërkesë padisë për lëshimin e urdhërave mbrojtës. Më konkretisht aktorët e reagimit të koordinuar marrin përsipër të sensibilizojnë komunitetin në lidhje me faktin që dorëzimi i formateve të kërkesë - padisë për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes bëhet tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- b. Të marrin në konsideratë sugjerimet e mundshme nga Gjykata në lidhje me përshpejtimin/saktësimin e procedurave të caktuara përsa i takon UM dhe UMM;
- c. Të konsultohen herë pas here me ekspertët e Gjykatës në lidhje me rastet specifike të dhunës në familje, si dhe mënyrat më të mira të mundshme të trajtimit/zgjidhjes së tyre.

#### **D. Prokuroria e Rrethit Vlorë, ka këto përgjegjësi dhe detyrime specifike:**

- *Të sigurojë një analizë të çështjeve ligjore të paraqitura; Në këtë kuadër, Prokuroria në vijim të përmbushjes së këtij detyrimi, merr përsipër edhe mbledhjen e kujdesshme të provave përkatëse, sikurse dhe ndarjen e informacionit të kërkuar (shpjeguar edhe në paragrafet e mësipërme të kësaj marrëveshjeje) mes antarëve të tjerë të sistemit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje.*
- *Të përcaktojë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe ndjekjen efikase të rastit; Të marrë pjesë në përpjekjen e përbashkët dhe të ndihmojë me zgjidhjen e çështjeve që ngrihen; Të jetë i gatshëm 24 orë në ditë për 7 ditë e javës për ndërhyrjen në rastet e shkeljes së urdhrave të mbrojtjes ose të rasteve të tjera më serioze të dhunës; E rëndësishme në përmbushjen e këtyre detyrimeve është veçanërisht angazhimi për trajtimin me seriozitet, efektivitet dhe në kohë sidomos të rasteve të shkeljes/thyerjes së urdhërave mbrojtës, me qëllim krijimin e një praktike të mbrojtjes më të mirë të viktimave dhe respektimit maksimal të drejtësisë së vendosur përmes vendimeve të Gjykatës. Në këtë kuadër, për kontaktime dhe detaje të mëtejshme mbi rastet, prokuroria vë në dispozicion të viktimave të dhunës në familje, apo sistemit të reagimit të koordinuar, mundësinë e kontaktimit me prokurorët e gatshëm, bazuar në grafikun përkatës.*
- *Të ofrojë ndihmë dhe këshillim ligjor për Reagimin e Koordinuar të Komunitetit, gjë e cila do të përmirësojë llojet e rasteve që janë paraqitur; Duke pasur parasysh specifikat për mbledhjen e të dhënave dhe trajtimin e çështjeve penale, ka shumë rëndësi këshillimi i të gjithë antarëve të skuadrës së reagimit të koordinuar dhe në veçanti i Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”, mbi mënyrën se si mund të mblidhen faktet dhe të adresohen në mënyrë specifike llojet e rasteve të dhunës në familje.*
- *Të ndihmojë viktimat me prezantimin e akuzave penale për dhunën në familje; Të informojë viktimat për mënyrën e depozitimit të akuzave penale, për dokumentacionin që nevojitet dhe për veprimet që ata duhet të kryejnë që çështjet të përparojnë; Sërish në vijim të pikës së sipërpërmendur, Prokuroria luan një rol shumë të rëndësishëm veçanërisht për informimin e viktimave mbi mënyrën se si mund të depozitojnë akuzat penale, dokumentacionin që duhet të plotësojnë dhe paraqesin, etj. Këtë përgjegjësi mund ta përmbushë më së miri në bashkëpunim dhe me mbështetjen edhe të avokates të punësuar pranë Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.*

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të Prokurorisë Vlorë, të gjitha palët e tjera në këtë Marrëveshje bien dakort:

- a. Për raste specifike të dhunës në familje, apo për denoncimin dhe ndjekjen e rasteve penalisht, të mbajnë kontakte të ngushta dhe të vazhdueshme me Prokurorinë.
- b. T’ju komunikojnë viktimave apo personave të interesuar mënyrën e kontaktimit apo të ndjekjes së rasteve përmes Prokurorisë, duke vendosur paralelisht kontakte me këta të fundit.
- c. Të marrin në konsideratë sugjerimet për përmirësimin e funksionimit me efektivitet të sistemit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje, veçanërisht kur bëhet fjala për ndjekjen e rastit penalisht, apo për shkelje të urdhërave të mbrojtjes.

#### **E. Zyra e Përmbarrimit ka këto detyrime dhe përgjegjësi:**

- Të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve të gjykatës në lidhje me urdhërat mbrojtës;
- Të kërkojë ndihmën dhe bashkëpunimin me organet përkatëse (polici, prokurori) në rast konstatimi të vështirësive në zbatim të urdhërave apo në rast shkeljeje të tyre;
- Të prioritarizojë dhe të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve të mësipërme , vecanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, gjendjes civile, etj.

**F. Mjeku Ligjor ka këto detyrime dhe përgjegjësi specifike:**

- Të marrë masa për ekzaminimin e menjëhershëm dhe sipas patrametrave të kërkuar të viktimave të dhunës në familje që i paraqiten;
- Të vijojë me procedurat përkatëse pas ekzaminimit mjeko-ligjor, duke prioritarizuar raste e dhunës në familje;
- Të prioritarizojë dhe të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve të mësipërme , vecanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, gjendjes civile, etj.

**G. Strukturat si Drejtoria e Shëndetit Publik, Qendra Shëndetësore dhe Spitali i Vlorës, kanë këto përgjegjësi dhe detyrime specifike:**

- *Të sigurojnë kujdes mjekësor të menjëhershëm dhe konfidencial sipas nevojës së viktimës; Kjo nënkupton që menjëherë me paraqitjen e një rasti të dhunës në familje, spitali, qendra e kujdesit shëndetësor parësor apo urgjenca, të vihen në dispozicion të trajtimit të rastit me prioritet dhe kundrejt të gjitha procedurave e standarteve përkatëse. Njëkohësisht, për çdo rast të paraqitur drejtpërsëdrejti në spital (pra ku këto qendra të kujdesit janë pika e parë e kontaktit me viktimën), të venë në dijeni Koordinatorin vendore.*
- *T'u japin dokumentacionin mbi lëndimet dhe raportet e sakta viktimave dhe në bazë të kërkesës edhe gjykatave; Në kuadër të plotësimit të këtij detyrimi, ka shumë rëndësi njohja e personelit dhe kërkimi i plotësimit në mënyrë të detyruar të formateve përkatëse të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë me qëllim mbajtjen shënim të rasteve të dhunës në familje. Një kopje e raportit të vizitës duhet t'i jepet në çdo rast viktimës (apo shoqëruesit/es së saj). Ndërkohë këto struktura shëndetësore duhet të zbatojnë edhe detyrimin për raportimin mujor të rasteve, bazuar në respektimin e konfidencialitetit, si edhe në masat që do merren në vijim të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.*
- *T'i ndjekin viktimat për nevojat e tyre shëndetësore dhe të sigurojë shëndetin e tyre; Në këtë kuadër, të gjitha strukturat shëndetësore të mësipërme, duhet të mbajë marrdhënie të vazhdueshme me Koordinatorin vendore, sikurse dhe të marrin në konsideratë e të ndjekin vazhdimisht rastet që referohen nga antarë të tjerë të mekanizmit referues.*
- *Të marrin pjesë në mekanizmin referues për të ofruar lidhjen mjekësore dhe perspektivën për zhvillimin e një reagimi të plotë për viktimat; Në këtë kuadër, strukturat shëndetësore të mësipërme duhet të ofrojnë vazhdimisht konsulencë dhe perspektivën se si mund të trajtohet më mirë shëndeti i viktimave të dhunës në familje, nisur nga shembujt e rasteve të menaxhuara.*
- *Të trajtojnë personelin tjetër mjekësor për identifikimin e dhunës në familje dhe të sigurojnë burimet dhe shërbimet për viktimat që mund të kërkojnë ndihmë, pa i bërë publik emrat e tyre; Nga kjo pikpamje ka shumë rëndësi evidentimi i nevojave specifike për trajnim apo materiale, bazuar edhe në Protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë (formularë, rregullore, urdhërat përkatës në funksion të zbatimit të Ligjit 9669, etj), si dhe më pas adresimi i tyre*

tek Koordinatorja vendore dhe antarët e reagimit të koordinuar, me qëllim trajtimin dhe plotësimin e tyre.

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të Drejtorisë së Shëndetit Publik, Qendrës Shëndetësore dhe Spitalit Vlorë, të gjitha palët e tjera në këtë marrëveshje bien dakort:

- a. Të kontaktojnë menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme në varësi të rastit me personin e kontaktit të përcaktuar nga qendra shëndetësore dhe spitali;
- b. Për rastet e dhunës në familje të bëhen lidhjet me strukturat shëndetësore përkatëse në varësi të zonave ku ndodh ngjarja.

#### **H. Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë, ka këto detyrime dhe përgjegjësi:**

- Të marrë pjesë në shqyrtimin dhe ndjekjen e rasteve, deri në përfundimin e tyre.
- Të mbështesë ndjekjen e rastit sidomos me referimet që mund të nevojiten në institucione rezidenciale apo qendrat pritëse;
- Të asistojë në përgatitjen e dosjes përkatëse të rastit duke u koordinuar me qendrat që ofrojnë këto shërbime.

#### **I. Drejtoria Arësimore Rajonale e Vlorës ka këto përgjegjësi dhe detyrime:**

- *Zhvillimi i kurrikulave; Integrimi në kurset ekzistuese; Garantimi që çdo nxënës të njohë dhe të informohet për dinamikën, për incidentet, për ligjin dhe burimet lidhur me dhunën në familje;*
- *Trajnimin e mësuesve në lidhje me identifikimin, reagimin, burimet dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në familje;*
- *Të raportojnë rastet e identifikuar të dhunës në familje, tek Koordinatorja Vendore.*
- *Të kujdesen për zbatimin e urdhërave mbrojtës, kur këto përcaktojnë detyrime për dhunuesin për të mos kontaktuar fëmijët apo për të mos iu afruar godinave të tyre arësimore (kopshte, shkolla, etj). Në rast të shkeljes së këtyre urdhërave mbrojtës, drejtuesi/ja i institucionit duhet të njoftojë menjëherë policinë dhe Koordinatorin Vendore*

Në kuadër të këtyre përgjegjësive dhe detyrimeve të Drejtorisë Arësimore Rajonale Vlorë, të gjitha palët e tjera në këtë marrëveshje bien dakort:

- a. Të bashkëpunojnë me Drejtorinë Arësimore dhe personelin e strukturave arësimore përkatëse veçanërisht në organizimin e fushatave ndërgjegjësuese për dhunën në familje;
- b. Të koordinohet me këto struktura kur bëhet fjalë për identifikimin dhe trajtimin e rasteve specifike;
- c. Në rast nevojë për zhvendosje të viktimës nga banesa dhe territori i saj, të koordinohet me Drejtorinë Arësimore me qëllim sistemimin sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të zgjedhur e të sigurt të fëmijëve në shkolla të tjera, me qëllim vijimin normal të procesit mësimor.

#### **J. Zyra Rajonale e Punësimit, ka këto detyrime dhe përgjegjësi:**

- Të përfshijë dhe trajtojë me prioritet të gjitha rastet e viktimave të dhunës në familje, në programet për nxitje e punësimit dhe formimit profesional;
- Të marrë masa në sistemimin e këtyre viktimave në programe të caktuara të formimit profesional, varësisht nevojave të tyre;
- Të shqyrtojë me prioritet dhe procedura të përsheptuara të gjitha rastet e dhunës në familje që referohen nga sistemi i reagimit të koordinuar;

- Në rast identifikimi/konstatimi të një situatë të dhunës në familje, të bëjë menjëherë informimin dhe referimin në antarët e sistemit të reagimit të koordinuar, sikurse është shpejtuar në paragrafët e mësipërm të kësaj Marrëveshjeje;
- Të ndihmojë në sensibilizimin dhe informimin e komunitetit dhe veçanërisht të grave dhe vajzave, mbi sistemin e reagimit të koordinuar të ngritur në Durrës, si dhe mbi mbrojtjen dhe ndihmën që mund t'ju ofrohet viktimave të dhunës në familje nga ky sistem si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Të identifikojë dhe adresojë nevojat për trajnimin e personelit veçanërisht në lidhje me komunikimin, krijimin e besimit si dhe informimin e referimin e rasteve të dhunës në familje.

**K. Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, ka këto detyrime dhe përgjegjësi:**

- Të ofrojë shërbime sociale rast pas rasti, për viktimat e dhunës në familje.
- Të ofrojë strehëz falas për një afat të papërcaktuar për gratë, viktimat e dhunës në familje, si edhe për fëmijët e tyre, bazuar edhe në vendimet për UMM/UM të dhëna nga Gjykata, si edhe në rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj organizate.
- Të ofrojë asistencë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.
- Të ofrojë ndërmjetësim për punësim për viktimat e dhunës në familje.
- Të ofrojë këshillim psikologjik falas për viktimat e dhunës në familje si edhe për fëmijët e tyre.
- Të trajtojë Specialistin e Dhunës në Familje të emëruar nga bashkia dhe që qëndron në zyrat e “Vatrës” (znj. Rezarta Andoni) në lidhje me punën direkte për ofrimin e shërbimit psikologjik dhe mbështetjes emocional, viktimave të dhunës në familje.
- Të përfshijë Specialistën e Dhunës në Familje të Bashkisë në Grupin Social (ekip antarësh të specializuar) të “Vatrës”, si edhe ta angazhojë atë përmes këtij grupi, në veprime të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit, në lidhje me fenomenin e dhunës në familje.

Në kuadër të këtyre përgjegjësiave dhe detyrimeve të Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” Vlorë, të gjitha palët e tjera në këtë marrëveshje bien dakort:

- a. Të kontaktojnë me këtë qendër në lidhje me ofrimin e shërbimeve të specializuara viktimave të dhunës në familje;
- b. Të trajtojnë me prioritetet rastet që iu adreson “Vatra” veçanërisht kur bëhet fjalë për shërbime shëndetësore apo ligjore. Në këtë kuadër, çdo rast i adresuar nga “Vatra” pranë aktorëve përgjegjës pjesë e kësaj marrëveshjeje, duhet të jetë i shoqëruar nga një punonjës i “Vatrës”, ose duhet të jetë i pajisur me një vërtetim që provon se rasti në fjalë ka pësuar dhunë në familje dhe është pjesë e rasteve që trajtohen nga kjo qendër.
- c. Të ftojnë Vatrën në takime konsultative me qëllim përmirësimin e shërbimeve dhe ndërgjegjësimit për problemin e dhunës në familje në Vlorë.